



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

KGJK.nr.494/2022  
Datë: 27 dhjetor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 23 dhe 32 paragrafi 10 i Rregullores Nr. 04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjes dhe Themelimit e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave, në mbledhjen 301-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, merr këtë:

### V E N D I M

- I. Znj. Shqipe Temaj, përzgjedhet zëvendës administratore e Gjykatës Themelore Prishtinë.
- II. Mandati i znj. Temaj si zëvendës administratore do të filloj nga data 01 janar 2023 dhe është pa afat të caktuar.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2022.

### A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.256/2022, ka shpallur konkurs për pozitë të lirë për zëvendës administrator të Gjykatës Themelore Prishtinë. Komisioni për rekrutimin e kandidatëve për pozitën zëvendës administrator të Gjykatës Themelore Prishtinë, i ka rekomanduar KGJK-së tre (3) kandidatë.

Këshilli, në takimin e mbajtur me datë 27 dhjetor 2022, pas shqyrtimit të rekomandimit të komisionit, me votim të fshehtë dhe shumicë të votave, përzgjedhi dhe emëroi znj. Shqipe Temaj, zëvendës administratore të Gjykatës Themelore Prishtinë, si në dispozitiv të këtij vendimi.



Albert ZOGAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Znj. Shqipe Temaj, zëvendës administratore e Gjykatës Themelore Prishtinë;
- Kryetares së Gjykatës Themelore Prishtinë;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.